



الحمد لله رب العالمين  
لله الحمد رب العالمين  
الحمد لله رب العالمين  
لله الحمد رب العالمين



# Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë

**Vullnet Merja**

**Tiranë, 2013 – Muharrem 1435**

Titulli:

## **AROMË BORZILOKU NGA TOKA E KERBELASË**

Përmblodhi materialin:

### **Vullnet MERJA**

Redaktoi:

**Jetmir ÇELA**

Korrektori:

**Sonila QAZIMI**

Përkujdesja kompjuterike:

**Sabrie FEZA**

Kopertina:

**Sabrie FEZA**

Botoi:

**Shoqata “FLLADI”**

**Emri: Husejn**

**Epiteti: Ebu Abdilah**

Babai: Imam **Ali bin Ebi Talib** (paqja qoftë mbi të!)

Nëna: **Hazreti Fatime e bija e Profetit**

**Muhammed** (paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të!)

Dita e Lindjes: **3 Shaban i vitit të katërt Hixhri**

Vendi i lindjes: **Medine**

Ai jetoi deri në moshën 57 vjeçare.

*Paqja qoftë mbi imam Husejnин*

*Paqja qoftë mbi Aliun, i biri i imam Husejnит*

*Paqja qoftë mbi heroinën e Qerbelasë, hazreti Zejneb*

*Paqja qoftë mbi heroin e Qerbelasë Ebul Fad Abbas*

*Paqja qoftë mbi fëmijët e imam Husejnит*

*Paqja qoftë mbi përkrahësit e imam Husejnит*

*Paqja qoftë mbi të gjithë ata që e pasojnë me devotshmëri rrugën e imam Husejnит*

*Allahu i mëshiroftë ato sy që vajtojnë për imam Husejnин*

*Allahu i forcoftë ato zemra që mbartin dashurinë për imam Husejnин.*

*Allahu i ndriçoftë ato mendje që e njohin ashtu siç duhet imam Husejnин*

*O Allah i Plotfuqishëm. Na mundëso të jemi në rrugën e imam Husejnит, e cila është rruga e gjyshit të tij, profetit Muhammed, dhe na bashko me ta në Ditën e Kijametit.*

## Fjala e Shoqatës

Jeta e personaliteteve të larta islame janë frymëzim për çdo mysliman në veçanti po ashtu edhe për mbarë njerëzit. Të shumtë janë personalitet e larta që i ka përmendur, i përmend dhe do t'i përmendë historia islame. Ata kurrë nuk do të harrohen, sepse qëllimi i tyre ishte udhëzimi i njerëzve në rrugën e drejtë. Një ndër ata është e imam Huseini (*paqja qoftë mbi të!*).

Imam Husejni (*paqja qoftë mbi të!*), para revolucionit të tij i ka thënë Muhamed ibn Aliut, i njohur si Ibnu'l Hanefijeh: "*Unë nuk kam dalë as si mosmirënlohës, as si arrogant, as si shkatërrues dhe as për të bërë padrejtësi. Unë kam dalë për të kërkuar reformim në ummetin e gjyshit tim (paqja dhe bekimet e*

*Vullnet Merja .....*

*Allahut qofshin mbi tē dhe mbi familjen e tij!), pér tē urdhëruar nē tē mira dhe pér tē ndaluar nga tē këqijat.” (Biharu'l-Enuar, vëllimi 44, f. 330.)*

Me këtë thënie madhështore dhe kuptimplotë, Prijësi i Dëshmorëve, Imam Husejni (*paqja qoftë mbi tē!*) sqaron qëllimin e revolucionit tē tij: tē urdhëruarit nē tē mirë dhe tē ndaluarit nga e keqja.

S'ka dyshim se ndodhia e Ashurasë, është lëvizja e dijes kundër padijes, e drejtësisë kundër padrejtësisë, e udhëzimit kundër devijimit dhe e tē vërtetës kundër tē pavërtetës.

Megjithëse janë shkruar e përkthyer me mijëra literatura, thua jse nē tē gjitha gjuhët e botës, përsëri ka shumë e shumë gjëra tē pazbuluara pér këtë lëvizje tē lirisë. Mendimtarët dhe dijetarët duhet tē punojnë akoma më shumë rrëth kësaj ndodhie madhështore.

..... *Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë*

Nëse do të studohen të gjitha dimensionet e saj, të cilat i gjejmë të mishëruara tek personaliteti i Imam Husejnit (paqja qoftë mbi të), pa dyshim që Ashuraja do të kuptohet më shumë.

Ashuraja nuk është festë, sepse edhe vetë Profeti është hidhëruar. Në historinë islame dhe në hadithet e transmetuara thuhet se profeti Muhamed e ka lajmëruar vrasjen e Imam Husejnит në tokën e Kerbelasë.

Ndër ato thënie përmendim:

El-Hakim En-Nijsaburij me sened nga Ummu Fadl bintu'l Harith, bashkëshortja e Abbas ibn Abdul Muttalibit, e cila ka shkuar tek i Dërguari i Allahut dhe i ka thënë: "O i Dërguari i Allahut, unë kam parë një ëndërr të keqe mbrëmë. Ai i tha: "Si ishte?" Ajo i tha: "Ishte e tmerrshme." Ai i tha: "Si ishte?" Ajo i tha: "Unë pashë sikur një pjesë e trupit

*Vullnet Merja .....*

tënd u pre dhe ra në prehërin tim.” I Dërguari i Allahut i tha: “Ke parë diçka të mirë. Fatimeja do të lindë, inshaAllah, një djalë dhe do të jetë në prehërin tënd.” Fatimeja lindi Husejnин dhe u vendos në prehërin tim, ashtu siç tha i Dërguari i Allahut. Një ditë, hyra te i Dërguari dhe e vendosa atë në prehërin e tij. Pastaj pashë sytë e të Dërguarit të Allahut që po lotonin. Ajo tha: I thashë: “O i Dërguari i Allahut, nëna ime dhe babai im qofshin kurban për ty! Çfarë ke?” Ai tha: “Më erdhi Xhebraili (paqja qoftë mbi të!) dhe më lajmëroi se ummeti im do ta vrasë këtë djalin (nipin) tim.” Unë i thashë: “Këtë?” Ai tha: “Po. Ai më solli edhe dheun e kuq.”

(El-Mustedrek ala’s-Sahihejn, 3/194, hadithi nr. 4818. E ka transmetuar Ibn Asakiri në Tarijkh Dimashk, 14/197.)

..... *Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë*

Meqenëse revolucioni i Imam Husejnit ishte për hir të Allahut dhe për të mbrojtur të drejtën dhe të vërtetën, dy shtyllat bazë të jetës së kësaj bote, ai do të jetë i përhershëm dhe do të vazhdojë deri në fund të kësaj jete.

Me rastin e Ashurasë (1435/2013) Shoqata “FLLADI” sjell në duart e besimtarëve myslimanë shqiptarë libërthin **“Aromë Borziloku nga Toka e Kerbelasë”**. Edhe pse i vogël në madhësi, shpresojmë që të jetë dobiprurës në përbajtje, me qëllim që besimtarë muslamanë shqiptarë të njihen sadopak me këtë figurë të lartë të historisë islame, Imam Husejin (paqja qoftë mbi të!).

Së fundi, Shoqata “FLLADI” falënderon të gjithë ata që ndihmuin në botimin e këtij libërthi.

Allahu na mundësoftë që të jemi në rrugën e Tij dhe në rrugën e të dashurve të

*Vullnet Merja .....*

Tij në këtë jetë dhe na bashkoftë me ta në  
Jetën Tjetër!

Drejtori  
Vullnet Merja

..... Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë

## HUSEJNİ (*paqja qoftë mbi të!*), DRITA E PESTË

Fillimi i muajit Muharrem përmban dy ndodhi të rëndësishme në historinë islame.

**E para:** Emigrimi i profetit Muhamed (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e Tij!*), i vulës së profetëve dhe i më të mirit prej tyre.

**E dyta:** Emigrimi i prijesit të dëshmorëve, Imam Husejn, të birit të Imam Aliut dhe Fatime Zahrasë (*paqja qoftë mbi ta!*).

**Vendi i nisjes për të dy emigrimet**  
**është i përbashkët:** është Meka, vendi më i shenjtë në rrugët tokësore. Nga kjo tokë nisi emigrimi i profetit Muhamed (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen*

*Vullnet Merja .....*

*e Tij!). Po nga kjo tokë nisi edhe emigrimi i Imam Husejnit (*paqja qoftë mbi të!*).*

**Shkaku i emigrimit ishte i njëjtë:** përpjekja për të ekzekutuar heroin e emigrimit. Kurthi që iu ngrit Profetit në Mekë për ekzekutimin e tij, ishte shkaku i largimit të tij prej saj. Po ashtu, i njëjti shkak ishte edhe për Imam Husejnин, (*paqja qoftë mbi ta!*), sepse edhe atë donin ta vrisnin po në Mekë, edhe nëse kapej pas mbulesës së Qabes. Për këtë arsyе ai emigroi prej saj.

**Qëllimi ishte i njëjtë:** gjetja e përkrahësve për të mbrojtur Islamin dhe për të zhdukur ngjyrat e padrejtësisë që ishin përhapur në kohën e Profetit dhe të Imam Husejnit (*paqja e Allahut qoftë mbi ta!*). Midis dy personaliteteve të emigrimit ka disa të përbashkëta të begata dhe prej tyre është Mbulesa (*Kisa*). Profeti Muhamed (*paqja dhe*

..... Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e Tij!), është i pari i pjesëtarëve të Mbulesës dhe Husejni (*paqja qoftë mbi të!*) është prej pjesëtarëve të kësaj mbulese.

Edhe pse muslimanët janë ndarë në medh'hebe, fraksione rryma dhe shkolla të shumta, të gjithë janë të mendimit se Husejni, i biri i Aliut (*paqja qoftë mbi ta!*) është nipi i Profetit Muhamed (*paqja dhe bekimet e Alahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e Tij!*). Të gjithë janë të mendimit se dashuria për Husejnин (*paqja qoftë mbi të!*) është dashuri për Allahun e Madhëruar. Profeti Muhamed (*paqja dhe bekimet e Alahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e Tij!*) ka thënë: “Husejni është prej meje dhe unë jam prej Husejnит. Allahu e do

*Vullnet Merja .....*

*atë që e do Husejnин. Husejni është nip prej nipave (sibtun mine'l esbat)."<sup>1</sup>*

Ai është vëllai i Imam Hasanit (*paqja qoftë mbi të!*). I Dërguari i Allahut ka thënë:  
*"Hasani dhe Husejni janë dy borzilokët e mi prej borzilokëve të dunjasë."<sup>2</sup>*

Sigurisht, të flasësh për virtytet e Imam Husejnит (*paqja qoftë mbi të!*) dhe të pjesëtarëve të tjerë të Familjes së Profetit, është tregues dashurie dhe dëshmi e thënies së Allahut të Madhëruar: **"Thuaj: Unë nuk kërkoj nga ju asnje shpërbirim përvëç dashurisë ndaj të afërmve."**<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> *El-Bukharij, Et-Tarijku'l-Kebijr*, 8:415/3536; *Sunenu't-Tirmidhij*, hadithi 3775; *Sunen Ibn Maxheh*, 1, hadithi 144; *Musned Ahmed*, 4:172; *Mesabihu's-Sunneh*, 4, hadithi 4833.

<sup>2</sup> *Sahihu'l-Bukhari*, Kitab Fadailu's-Sahabeh, Kapitulli i edukatës, Kreu "Mëshira e fëmijës"; *Sunenu't-Tirmidhij*, 5, hadithi 3770.

<sup>3</sup> *Surja Esh-Shura*, ajeti 23.

..... Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë

Revolucioni i Imam Husejnit (*paqja qoftë mbi ta!*) ka dimensione të shumta fetare, morale, shoqërore, humane, etj. Të shumtë janë mendimtarët, dijetarët dhe udhëheqësit të cilët kanë folur, flasin dhe do të flasin për Imam Husejnин (*paqja qoftë mbi të!*). Ky prijës simbolizon lirinë, pavarësinë, drejtësinë dhe udhëzimin për çdo njeri monoteist e të ndershëm në këtë jetë, pa dallim kombi, gjuhe, race a ngjyre.

Ndër ta është edhe heroi i madh dhe udhëheqësi i Indisë, Mahatma Gandhi, i cili ka thënë: "Mësova prej Husejnit (*paqja qoftë mbi të!*) si të triumfoj kur jam i privuar."

S'ka dyshim se me këto fjalë, ai dëshiron të vlerësojë e të nxjerrë në pah pozitën e lartë të Imam Husejnit (*paqja qoftë mbi ta!*), sakrificën e madhe të tij në rrugën e mbrojtjes së vlerave dhe të besimit të tij. Imam Husejni (*paqja qoftë mbi të!*) është

## Vullnet Merja .....

shembull për mbarë botën në përballjen me padrejtësinë dhe në sakrifikimin me gjithçka që zotëronte.

Dikush mund të pyesë: Çfarë bëri Imam Husejni (*paqja qoftë mbi të!*) dhe shokët e tij, derisa arritën të mirësohen me këtë pozitë të lartë, të cilën nuk ia kanë zilinë jo vetëm muslimanët, por edhe jomuslimanët? Imam Husejni (*paqja qoftë mbi të!*), me revolucionin e tij kristalizoi kuptimet më të larta të sakrificës dhe të flijimit. Ai nuk sakrifikoi vetëm veten e tij, por edhe fëmijët e tij dhe shokët më të afërt të tij. Ai i fliroi në rrugën e lartësimit të së vërtetës dhe të drejtësisë, me qëllim që të gjithë njerëzit, pa përjashtim, t'i mësojë që të mos u nënshtrohen padrejtësive dhe të padrejtëve në çdo vend e në çdo kohë.

..... *Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë*

# NDODHITË NË DITËN E ASHURASË SIPAS BURIMEVE TË EHLI SUNNETIT

“Ditën e martirizimit (*shehade*) të Husejnit qielli lëshoi gjak. Njerëzit dhe gjithçka e tyre u mbush me gjak. Shenjat e tij mbetën në rroba për një kohë, derisa ato u leckosën. Kjo e kuqe që shihet në qzellështë shfaqur ditën e vrasjes së tij dhe nuk shihej më parë.”

Prej burimeve të Ehli Sunetit: *Dhekhairu'l-'Ukba*, 144-145 dhe 150; *Tarikh Dimashk*, 4/339; *Es-Seua'iku'l-Muhrikah*, 116 dhe 192; *El-Khasaisu'l-Kubra*, 126; *Jenabi'u'l-Meueddeh* i Hameuijnit, 320 dhe 356; *Tedhkiretu'l-Khauas*, 284.

..... Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë

**“Kur ia sollën Mukhtarit kokën e Ubejdullah bin Zijadit dhe kokat e shokëve të tij, erdhi një gjarpër dhe hyri në mesin e kokave derisa hyri në gojën e Ibn Zijadit dhe doli nga hunda e tij. Hyri nga hunda dhe doli nga goja e tij. Ai hynte e dilte nga koka e tij në mesin e kokave. Njerëzit filluan të thonë: U zhgënje (humbi) Ubejdullahi dhe shokët e tij. Ata e humbën dynjanë dhe Ahiretin e tyre. Pastaj njerëzit u mallëngjyen derisa vajtuan duke qarë për Husejn, për fëmijtë e Husejnit dhe për shokët e Husejnit.”**

Prej burimeve të Ehli Sunetit: *Sahihu't-Tirmidhij*, 13/97; *Maktelu'l-Husejn*, 2/84; *Usdu'l-Gabeh*, 2/22; *El-Mu'xhemu'l-Kebiyr*, 145; *Dhekhairu'l-'Ukba*, 128; *Sijer A'lami'n-Nubela*, 3/359; *Es-Seua'iku'l-Muhrikah*, 196; *Jenabiu'l-Meueddeh*, 321; *Is'afu'r-Ragibijn*, 185; *Nuru'l-Ebsar*, 126; *Ihkaku'l-Hak*, 11/542-545.

*Vullnet Merja .....*

**“Kur u vra Husejni, shtatë ditë pasi falnin namazin e ikindisë, njerëzit e shikonin diellin nga anët e mureve sikur të ishte mbulesë e ngjyrosur prej fortësisë së ngjyrës së kuqe të tij dhe shikonin planetet sikur godisnin njëri-tjetrin.”**

Prej burimeve të Ehli Sunnetit: *El-Mu’xhemul Kebiyr*, 146; *Sijer A’lami’n-Nubela*, 3/210; *Tarikhu'l-Khulefa*, 80; *Es-Saua’iku'l-Muhrikah*, 192; *Ihkaku'l-Hak*, 11/465-466; *Is’afu'r-Ragibijn*, 251.

**“Kur u vra Husejni, për dy muaj apo tre, që nga namazi i agimit e deri në namazin e akshamit, njerëzit i shihnin muret sikur të ishin lyer me gjak.”**

Prej burimeve të Ehli Sunetit: *Tedhkiretu'l-Khauas*, 284; *El-Kamil fi't-Tarikh*, 3/301; *El-Bidajeh ue'n-Nihajeh*, 8/171; *Akhbaru'd-Duel*, 109; *Ihkaku'l-Hak*, 11/466-467.

**“Në qiel nuk dukej e kuqja derisa u vra Husejni dhe për katër muaj rresht,**

..... Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë grave në Perandorinë Bizantine, periodat (menstruacionet) u vinin të zbardhura. Mbreti bizantin i shkroi mwkëmbësit arab: Ju keni vrarë një profet ose djalin e një profeti."

Prej burimeve të Ehli Sunetit: *El-Mu'xhemu'l-Kebijr*, 146; *Maktelu'l-Husejn*, 2/90; *Tarijkh Dimashk*, 4/339; *Sijer A'lami'n-Nubela*, 3/211; *Es-Saua'iku'l-Muhrikah*, 19; *Mexhmau'z-Zeuaid*, 9/197; *Muntekhab Kenzi'l-'Ummal*, në margjinat e *Musnedit*, 5/112; *Jenabiu'l-Meueddeh*, 322 dhe 356; *Ihkaku'l Hak*, 11/471-473.

**"Qielli nuk ka qarë vetëm se për dy: Jahjanë të birin e Zekerijasë dhe Husejinin. Të qarët e qiellit do të thotë: të skuqet dhe të bëhet si trëndafil i kuq."**

Prej burimeve të Ehli Sunetit: *Tarikh Dimashk*, 4/339; *Kifajetu't-Talib*, 289; *Sijer A'lami'n-Nubela*, 3/210; *Tedhkiretu'l-Khauas*, 283; *Es-Saua'iku'l-Muhrikah*, 192; *Jenabiu'l-Meueddeh*,

*Vullnet Merja .....*

322; *Tefsiru Ibn Kethir*, 9/162; *Ihkaku'l-Hak*, 11/476-478.

**“Kur u vra Huseini, qielli u nxi e bë skëterrë e madhe. Planete u dukën ditën derisa u shfaq edhe konstelacioni i Binjakëve pasdite. Nga qielli ra dhë i kuq dhe qielli natën dukej si të ishte shushunjë.”**

Prej burimeve të Ehli Sunetit: *Tarijkh Dimashk*, 4/339; *Es-Saua'iku'l-Muhrikah*, 116.

**“Zogjtë e ndaluan të ngënënit ditën e Ashurasë.”**

Prej burimeve të Ehli Sunetit: *Maktelu'l-Husejn*, 2/101; *Ihkaku'l-Hak*, 11/492-493.

**“Kur u vra Husejni, korbi u ul te gjaku i tij. Pastaj u lye me gjak dhe u ul në Medine tek muri i shtëpisë së Fatimesë, bijës së Imam Husejnit.”**

Prej burimeve të Ehli Sunetit: *Maktelu'l-Husejn*, 2/92. *Ihkaku'l-Hak*, 11/492-493.

..... Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë

**“Kur u vra Husejni dhe ia prenë kokën, ata u ulën që të pinë verë. Nga muri doli një dorë që mbante një laps hekuri dhe shkroi me gjak: A shpreson umeti që vrau Husejnин shefatin e gjyshit të tij në Ditën e Llogarisë?”**

Prej burimeve të Ehli Sunetit: *El-Mu'xhemu'l-Kebiyr*, 147; *Dhekhairu'l-'Ukba*, 144; *Maktelu'l-Husejn*, 2/93; *Kifajetu't-Talib*, 291; *Tarikh Dimashk*, 4/342; *Tarikhu'l-Islam*, 3/13; *Mexhmau'z-Zeuaid*, 9/199; *El-Bidajeh ue'n-Nihaje*, 8/200; *Es-Saua'iku'l-Muhrika*, 116; *El-Khasaisu'l-Kubra*, 2/12; *Et-Tabakatu'l-Kubra*, 1/23; *Xhem'u'l-Feuaid*, 2/217; *Uesiletu'l-Meal*, 197; *Is'afu'r-Ragibijn*, 217; *Jenabiu'l-Meueddeh*, 230 dhe 315; *Ihkaku'l-Hak*, 11/561-565.

**“Ebu Rexhai ka thënë: ‘Mos e shani Aliun dhe as pjesëtarët e kësaj shtëpie. Një burrë nga Beni'l Hexhijm (një fqinj nga Belhexhim) erdhi nga Kufa dhe tha: ‘A nuk e keni dini se Allahu e vrau këtë të**

Vullnet Merja .....

**shthurur (*fasik*) e bir i të shthururit?!!! E kishte fjalën për Husejnin, të birin e Aliut. Në atë çast, Allahu e goditi me dy sende me majë në sytë e tij dhe ia mori shikimin.””**

Prej burimeve të Ehli Sunetit: *El-Menakib* i Ahmed ibn Hanbelit (dorëshkrim); *El-Mu'xhemu'l-Kebijr*, 145; *Tarikh Dimashk*, 4/430; *Kifajetu't-Talib*, 296; *Es-Saua'iku'l-Muhrikah*, 194; *Mexhmau'z-Zeuaid*, 9/196; *Akhbaru'd-Duel*, 109. *El-Mukhtar*, 22; *Tehdhibu't-Tehdhib*, 2/353; *Sijer A'lami'n-Nubela*, 3/211; *Jenabiu'l-Meueddeh*, 220; *Uesiletu'l-Meal*, 197. *Ihkaku'l-Hak*, 11/547-550.

**“Të gjithë ata që vranë Husejnin janë ndëshkuar në këtë dynja ose me vrasje, ose me verbëri, ose me nxirje të fytyrës, ose me largimin e pushtetit brenda një kohe të shpejtë.””**

Prej burimeve të Ehli Sunetit: *Et-Tedhkireh*, 290; *Is'afu'r-Ragibijn*, 192; *Jenabiu'l-Meueddeh*, 322; *Ihkaku'l-Hak*, 11/513.

“Një burrë që i bllokoi ujin Husejnit u sprovua me etje pasi Husejni u lut ndaj tij duke thënë: ‘O Zot! Mos ia shuaj etjen! O Zot! Mos ia shuaj etjen! O Zot! Mos ia shuaj etjen!’ Ai bërtiste prej nxehësisë në barkun e tij dhe ftohtit në shpinën e tij, derisa u fry barku i tij si fryrja e barkut të devesë.”

Prej burimeve të Ehli Sunnetit: *Maktelu'l-Husejn*, 2/91; *Dhekhairu'l-'Ukba*, 144; *Es-Sauaiku'l-Muhrikah*, 195; *Muxhabij'd-Da'ueh*, 38; *Ihkaku'l-Hak*, 11/514-515.

“Kur një person i tha Husejnit: ‘Përgëzohu me Zjarrin’, Husejni u lut ndaj tij dhe tha: ‘O Zot hidhe në Zjarr!’. Kali i tij u tremb në një vijë uji dhe ra mbi të. Këmba i ngeli në samar dhe koka e tij ra në tokë. Kali u ngrit i tërbuar dhe e mori me vete. Koka e tij godiste çdo gurë e dru derisa vdiq.”

*Vullnet Merja .....*

Prej burimeve të Ehli Sunnetit: *Tarikhul-Umemi ue'l-Muluk*, 4/327; *El-Mu'xhemul-Kebijr*, 146; *Maktelul-Husejn*, 2/94; *Dhekhairul-'Ukba*, 342; *El-Kamilu fit-Tarikh*, 3/289; *Kifajetu't-Talib*, 287; *Uesiletul-Meal*, 197; *Jenabiu'l-Meueddeh*, 342; *Ihkaku'l-Hak*, 11/516-519.

**“Kur ia ndaluan ujin Husejnit, një burrë tha: ‘Shikoje atë, duket sikur është mëlçi e qielilit, nga e cila nuk do të provosh pikën e ujit derisa të vdesësh i etur! Husejni tha: ‘O Zot! Vrite atë të etur!’ E, edhe pse pinte shumë ujë, nuk i shuhej etja derisa vdiq i etur.”**

Prej burimeve të Ehli Sunnetit: *Es-Saua'iku'l-Muhrikah*, 195; *Ihkaku'l-Hak*, 11/520.

**“Personat që i ndaluan ujin Husejnit dhe Husejni u lut kundër tyre vdiqën të etur.”**

..... Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë

“Verbëria e një burri dhe përfundimi i tij pa duar e pa këmbë, për shkak se ai hoqi rripin e Husejnit pasi Fatimeja e pa në ëndërr dhe u lut kundër tij.”

“Atij që grabiti çallmën e Husejnit iu pre dora deri në bërryl dhe jetoi i varfër dhe në gjendje të mjeruar derisa vdiq.”

“Ikja e mendjes dhe bllokimi i gjuhës së atij që tha: ‘Unë e vrava Husejnин’.”

Prej burimeve të Ehli Sunneti: *El-Bidaje ue'n-Nihaje*, 8/147; *Jenabiu'l-Meueddeh*, 348; *Maktelu'l-Husejn*, 2/34, 94 dhe 103; *Tarikh Dimashk*, 4/340; *El-Kamil fi't-Tarikh*, 3/283; *El-Mu'xhemu'l-Kebir*, 146; *Dhekhairu'l-'Ukba*, 144; *Kifajetu't-Talib*, 287; *Uesijletu'l-Meal*, 196; *Ihkaku'l-Hakk*, 11/522-525 dhe 528-530.

“Kur një grua u parfumos me parfumin e vjedhur nga çadrat e Husejnit, e goditi lebroza.”

*Vullnet Merja .....*

Prej burimeve të Ehli Sunetit: *El-'Akdu'l-Ferijd*, 2/220; *'Ujunu'l-Akhbar*, 1/221; *Ihkaku'l-Hakk*, 11/511.

**"Hermele mori pamjen më të shëmtuar dhe më të zezë, pasi nuk kalonte një natë pa shkuar me pahir drejt një zjarri të ndezur e sikur e shtynte diçka të futej në të."**

Prej burimeve të Ehli Sunetit: *Et-Tedhkireh*, 291; *Jenabi'u'l-Meueddeh*, 330; *Is'afu'r-Ragibijn*, 192; *Nuru'l-Ebsar*, 123; *Ihkaku'l-Hakk*, 11/531-532.

**"Kur një person tha: 'Ai që ka ndihmuar në vrasjen e Husejnит ёshtë sprovuar para se të vdesë', një burrë i moshuar ka thënë: 'Unë jam prej atyre që e kam marrë pjesë në atë vrasje. Që nga ai moment nuk më ka goditur ndonjë gjë e keqe.' Atij iu shua kandili dhe mori ta rregullonte. Mori flakë, u turr me shpejtësi**

..... Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë për në Eufrat dhe u hodh në të. Ai u ndez dhe u bë shkrumb."

Prej burimeve të Ehli Sunetit: *Maktelu'l-Husejn*, 62; *Tarikh Dimashk*, 4/340; *Kifajetu't-Talib*, 279; *Et-Tedhkireh*, 292; *Uesiletu'l-Meal*, 197; *Sijer A'lami'n-Nubela*, 3/211; *Es-Saua'iku'l-Muhrikah*, 193; *Jenabiu'l-Meuddeh*, 322; *Is'afu'r-Ragibijn*, 191; *Ihkaku'l-Hakk*, 11/536-539.

## **ASHURAJA NË PIKËPAMJET E DISA FILOZOFËVE, MENDIMTARËVE, UDHËHEQËSVE DHE POLITIKANËVE TË BOTËS**

Ndodhia e Kerbelasë ka ndikuar shumë në mendimet e njerëzve, deri edhe tek ata jomuslimanë. Madhështia e revolucionit dhe e sakrificës së Imam Husejnit (*paqja qoftë mbi të!*) dhe të shokëve të tij ka bërë që të lindin shumë mendime dhe opinione rrëth këtij revolucioni të përgjakur. Për të përmendur të gjitha ato mendime dhe opinione duhen literatura të shumta. Ka edhe dijetarë jomuslimanë të cilët kanë shkruar rrëth kësaj ndodhie.

Më poshtë do të përcjellim mendimet e disa prej personaliteteve muslimane dhe jomuslimane për Imam Husejnin (*paqja qoftë mbi të!*):

**Gandi, udhëheqësi i Indisë ka thënë:**  
“Unë e kam lexuar jetën e Imam Husejnit, dëshmorit të madh të Islamit. I kam shfletuar

..... Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë me vëmendje faqet e Kerbelasë. Mua mu qartësua se, nëse India dëshiron triumfin, duhet patjetër që të ndjekë jetëshkrimin e Imam Husejnit (*paqja qoftë mbi të!*)."  
(Marrë nga: [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

**Muhamed Ali Xhenah, themeluesi i shtetit të Pakistanit ka thënë:** "Nuk gjen në botë shembull për trimërinë dhe guximin si sakrifica e Imam Husejnit (*paqja qoftë mbi të!*) me veten e tij. Besoj se të gjithë muslimanët duhet ta ndjekin dhe ta marrin shembull këtë burrë që sakrifikoi me veten e vet në tokën e Irakut."

(Marrë nga: [www.alkawthar.com](http://www.alkawthar.com))

**Carls Dikens, shkrimtar i njohur anglez ka thënë:** "Nëse Imam Husejni (*paqja qoftë mbi të!*) do të kishte luftuar për qëllimet e kësaj jete, nuk e kuptoj pse duhet të merrte me vete gratë, të rinjtë dhe fëmijët?! Atëherë,

*Vullnet Merja .....*

logjika gjykon se ai sakrifikoi vetëm për hir të Islamit."

(Marrë nga: [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

**Tomas Karlajl, filozof dhe historian anglez ka thënë:** "Mësimi më i lartë që mësojmë prej fatkeqësisë së Kerbelasë është se Husejni (*paqja qoftë mbi të!*) dhe përkrahësit e tij kishin besim të fortë te Zoti. Ata vërtetuan me veprën e tyre se inferioriteti numerik nuk ka rëndësi në përballje mes së drejtës dhe të padrejtës. Ajo që më habit është triumfi i Husejnит, edhe pse ishin të paktë ata që ishin me të."

(Marrë nga: [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

**Eduard Braun, orientalist anglez, ka thënë:** "A ka zemër që nuk e mbulon hidhërimi dhe dhimbja kur dëgjon të flitet për Kerbelanë? Madje edhe jomuslimanët

..... Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë nuk mund ta mohojnë pastërtinë e shpirtit që ra në këtë betejë.”

(Marrë nga: [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

**Frederik Xhejms:** “Thirrja e Imam Husejnит (*paqja qoftë mbi të!*), apo edhe e ndonjë heroi tjetër dëshmor është se në këtë jetë ka parime konstante për drejtësinë, mëshirën dhe dashurinë, të cilat nuk ndryshohen. Kjo thirrje na vërteton se sa herë shfaqet një person në mbrojtje të këtyre virtyteve dhe i fton njerëzit që të kapen pas tyre e t'i zbatojnë ato, këtyre vlerave dhe parimeve u shkruhet përforcimi dhe vazhdimësia.”

(Marrë nga: [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

**L. M. Bojd ka thënë:** “Prej natyrës së njeriut është se ai e do guximin, trimërinë, përparimin, lartësimin shpirtëror, hovin dhe shpirtmadhësinë. Kjo e çon lirinë dhe

*Vullnet Merja .....*

drejtësinë të dorëzohen përballë padrejtësisë dhe shkatërrimit. Këtu qëndron guximi dhe madhështia e Imam Husejnit. Është prej kënaqësisë time që të jem prej atyre që e lavdërojnë me gjithë shpirt për këtë sakrificë të madhe, edhe pse kanë kaluar më shumë se 1300 vjet nga ndodhia e saj.”

(Marrë nga: [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

**Uashington Irving, historian i njohur amerikan, ka thënë:** “Imam Husejni (*paqja qoftë mbi të!*) e kishte më të lehtë të shpëtonte veten e tij duke iu dorëzuar dëshirës së Jezidit. Por, misioni i udhëheqësit, i cili ishte shkak i shpërthimit të revolucioneve në Islam, nuk e lejonte atë të pranonte Jezidin për kalif. Përkundrazi, ai e ofroi veten e tij për t'u bërë ballë të gjitha presionieve dhe tragjedive, për të shpëtuar Islamin nga kthetrat e Beni Ummejje-s. Shpirti i Husejnit (*paqja qoftë mbi të!*) qëndron gjithmonë, kurse

..... Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë trupi i tij ra në rërën e nxehëtë. O hero! O shembull i trimërisë! O kalorës, o Husejn!”  
(Marrë nga: [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

**Tomas Masarijk ka thënë:** “Edhe pse priftërinjtë tanë ndikojnë në ndjenjat e njerëzve kur përmendin fatkeqësitë e Mesihut (Jezusit), mirëpo tek ndjekësit e Mesihut ti nuk e gjen atë entuziazëm dhe emocion që e gjen te pasuesit e Husejnit (*paqja qoftë mbi të!*). Më duket se shkaku është që fatkeqësitë e Mesihut në krahasim me fatkeqësitë e Husejnit (*paqja qoftë mbi të!*) nuk përfaqësojnë veçse një fije kashtë përballë një mali madhështor.”

(Marrë nga: [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

**Moris Dukabrij:** “Në tubimet vajtimore thuhet se Husejni (*paqja qoftë mbi të!*) sakrifikoi veten e tij për të mbrojtur dinjitetin dhe nderin e njerëzve, si dhe

## *Vullnet Merja .....*

shenjtërinë e Islamit. Ai nuk i hapi rrugën tiranisë dhe tekave të Jezidit. Prandaj, ejani ta marrim shembull që të shpëtojmë prej kolonializmit dhe të preferojmë vdekjen e ndershme ndaj jetës së poshtëruar e të nënshtruar.”

(Marrë nga: [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

### **Orientalisti gjerman Marbijn:**

“Nëpërmjet sakrificës dhe flijimit me njerëzit më të shtrenjtë të tij dhe nëpërmjet konstatimit të së drejtës së tij, Husejni (*paqja qoftë mbi të!*) i dha një mësim sakifice e në flijimi njerëzimit. Ai e futi Islamin dhe muslimanët në regjistrin e historisë dhe ua ngriti famën atyre. Ky ushtar i pamposhtur i botës islame konstatoi për të gjithë njerëzit se padrejtësia nuk është e qëndrueshme. Ai qartësoi se padrejtësia, sado të duket e fortë dhe e madhe nga jashtë, përballë të vërtetës duket si pupla që e merr era.”

(Marrë nga [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

..... Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë

**Bintu'sh-Shati':** "Zejnebja, motra e Imam Husejnit (*paqja qoftë mbi të!*) ua prishi qejfin e fitores Ibn Zijadit dhe emevitëve. Ajo hodhi 'pika helmi' në 'gotat e triumfit' të tyre. Zejnebja, heroina e Kerbelasë, ka luajur rol stimulues në të gjitha ndodhitë politike pas Ashurasë, siç ishin: kryengritja e Mukhtarit, kryengritja e Abdullah ibn Zubejrit, rënia e shtetit emevit, themelimi i shtetit abasit dhe përhapja e medh'hebit shiit."

(Marrë nga: [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

**Lijakat Ali Khan, kryeministri i parë i Pakistanit:** "Kjo ditë prej ditëve të Muharremit ka domethënje të madhe e të thellë tek muslimanët në të gjithë botën. Në këtë ditë ndodhi një prej ndodhive më pikëlluese dhe më trishtuese në historinë e Islamit. Martirizimi i Husejnit (*paqja qoftë mbi*

*Vullnet Merja .....*

*të!), me gjithë pikëllimin që përmban, tregon për shpirtin e vërtetë islam, sepse ai (martirizimi) përfaqëson dorëzimin e plotë ndaj vullnetit të Allahut. Ne mësojmë prej martizimit të tij që të mos frikësohami dhe të mos devijojmë nga rruga e drejtë dhe e vërtetë, sado të mëdha jenë problemet dhe rreziqet.”*

(Marrë nga: [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

**Xhorxh Xhordak, dijetar dhe letrar i krishterë:** “Kur Jezidi përgatiti njerëzit për vrasjen e Husejnит (*paqja qoftë mbi të!*) dhe për gjakderdhje ata thoshin: ‘Sa para na jep?’ Kurse përkrahësit e Husejnит (*paqja qoftë mbi të!*) thoshin: ‘Sikur të vritemi shtatëdhjetë herë, ne jemi të gatshëm që të luftojmë me ty dhe të vritemi përsëri.’”

(Marrë nga: [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

..... Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë

**Abbas Mahmud El-'Akkad,**  
**shkrimtar egjiptian:** "Revolucionari i Husejninit (*paqja qoftë mbi të!*) është një prej revolucioneve të vetme në histori. Deri tani nuk ka patur të njëjtë me të në fushën e propagandave fetare apo të revolucioneve politike. Pas tij, shteti u asgjësua dhe nuk qëndroi më gjatë sesa mosha e një njeriu të zakonshëm. Nuk kaloi nga koha e historisë së revolucionit të Husejninit (*paqja qoftë mbi të!*) e deri në rënien e shtetit më shumë se gjashtëdhjetë e pak vjet."

(Marrë nga: [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

**Ahmed Mahmud Subhi:** "Edhe pse Husejn ibn Aliu (*paqja qoftë mbi të!*) u mund në nivel politik apo ushtarak, historia nuk ka dëshmuar asnjëherë për humbjen që përfundon në favor të të humburve, siç përfundoi në favor të gjakut të Husejninit (*paqja qoftë mbi të!*). Gjakun e Husejninit (*paqja*

*Vullnet Merja .....*

*qoftë mbi të!) e pasoi revolucioni i Ibn Zubejrit, kryengritja e Mukhtarit e të tjera revolucionare deri në rënien e shtetit emevit. Zëri i kërkimit të gjakut të Husejninit u shndërrua në një thirrje, e cila tronditi frone dhe shtete.”*

(Marrë nga: [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

**Antuan Bara, gazetar i krishterë sirian:** “Sikur Husejni (*paqja qoftë mbi të!*) të ishte prej nesh, në çdo vend do të përhapnim për të një flamur dhe në çdo vend do të ngrinim një foltore, nga ku do të ftonim njerëzit në Krishtërim me emrin e Husejninit (*paqja qoftë mbi të!*).”

(Marrë nga: [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

**Gibon, historian anglez:** “Edhe pse ka kaluar shumë kohë nga tragjedia e Kerbelasë, edhe pse ne nuk na bashkon me personazhin e tragjedisë i njëjtë vatan,

..... Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë megjithatë, fatkeqësitë dhe tragjeditë që i ndodhën Husejnit (*paqja qoftë mbi të!*), vënë në lëvizje ndjenjat e lexuesit, edhe sikur të jetë më zemërforti ndër njerëz. Ai ndien në veten e tij një lloj dhembshurie dhe tërheqjeje nga ky personalitet.”

(Marrë nga: [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

### **Nikolson, orientalist i njojur:**

“Emevitët ishin të padrejtë, tiranë dhe shtypës. Ata i harruan rregullat islame dhe i nënvleftësonin muslimanët. Nëse do të studiojmë historinë, do të gjëjmë se feja u ngrit kundër tiranisë dhe shtypjes dhe se shteti fetar u përball me sistemin perandorak. Për këtë, historia gjykon drejt se gjaku i Husejnit (*paqja qoftë mbi të!*) është në qafë të emevitëve.”

(Marrë nga: [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

*Vullnet Merja .....*

**Sër Persi Sajkus, orientalist anglez:**

“Është e vërtetë se trimëria dhe heroizmi që shfaqqi ky grup i vogël, ishin në atë shkallë, saqë gjithkush që dëgjoi për të e lavdëroi dhe i bëri komplimente padashur. Ky grup trim e i ndershëm e bëri veten e tij të njohur, të lartë dhe të përhershëm, i cili kurrë nuk do të zhduket.”

(Marrë nga: [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

**Tamelas Tundun, kryetari i mëparshëm i Asamblesë Kombëtare të Indisë:** “Këto sakrifica madhështore, si martirizimi i Imam Husejnит (*paqja qoftë mbi të!*), kanë ngritur nivelin mendor të njerëzimit. Ky kujtim duhet të na qëndrojë përgjithmonë dhe të përmendet vazhdimisht.”

(Marrë nga: [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

..... Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë

**Muhamed Zaglul Basha, ka thënë:**

“Vërtet, Husejni (*paqja qoftë mbi të!*) me këtë vepër të tij e përçoi detyrën e tij fetare dhe politike. Të tilla tubime vajtimi edukojnë te njerëzit shpirtin e burrërisë dhe zhvillon në brendinë e tyre fuqinë e vullnetit në rrugën e të drejtës e të vërtetës.”

(Marrë nga: [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

**Abdurrahman Esh-Sherkauij,**

**shkrimtar egjiptian:** Husejni është dëshmor i rrugës së fesë dhe lirisë. Nuk duhet që vetëm shiuëtët të krenohen me emrin e Husejnит (*paqja qoftë mbi të!*), por të gjithë të lirët e botës të krenohen me këtë emër.”

(Marrë nga: [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

**Taha Husejn, dijetar dhe letrar i madh egjiptian:** “Husejni (*paqja qoftë mbi të!*) digjëj nga malli për të shfrytëzuar kohën, të

*Vullnet Merja .....*

rifillonte xhihadin dhe të ecte në gjurmët e babait të tij. Ai e la të lirë Muavijen dhe mëkëmbësit e tij deri në atë masë, saqë Muavija filloi ta kërcënonte. Mirëpo Husejni (*paqja qoftë mbi të!*) i angazhoi përkrahësit e tij që të kapeshin me të drejtën dhe të vërtetën.”

(Marrë nga: [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

**Abdul Hamid Xheudet Es-Sahar, shkrimitar egjiptian:** “Husejni (*paqja qoftë mbi të!*) nuk ia dha besën Jezidit dhe nuk iu nënshtrua udhëheqjes së tij. Sepse një veprim i tillë ka kuptimin e përhapjes së shthurjes, devijimit, forcimit të bazave të padrejtësisë e të tiranisë dhe mbështetjen e qeverisë së paligjshme. Husejni (*paqja qoftë mbi të!*) nuk ishte i kënaqur me këto veprime derisa u robëruan familja dhe fëmijtë e tij dhe u vra së bashku me përkrahësit e tij.”

(Marrë nga: [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

..... Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë

**Eruditi Tantauij, dijetar dhe filizof egjiptian:** “Epopeja husejnite ngjall tek të lirët mallin për sakrificë në rrugën e Allahut (xh.sh.) dhe e bën pritjen e vdekjes dëshirën më të mirë. Ajo i bën ata të garojnë për te gjiri i martirizimit (*shehade*).”

(Marrë nga [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

### **El-Ubejdij, Mufti i Mosulit:**

“Tragjedia e Kerbelasë është e rrallë në historinë njerëzore. Po ashtu edhe pjesëmarrësit në të janë të rrallë. Imam Husejni (*paqja qoftë mbi të!*) mendoi se është prej obligimeve të tij që të kapet fort pas traditës së mbrojtjes së të drejtave të të privuarve dhe të interesave të përgjithshme bazuar në ligjin e Allahut në Kur'an dhe në ato që solli i dërguari fisnik. Ai nuk hezitoi të ecë në të dhe sakrifikoi veten e tij në atë thertore të madhe. Ai u bë tek Zoti i tij, prijësi i dëshmorëve; në historinë e ditëve u

*Vullnet Merja .....*

bë udhëheqësi i reformatorëve dhe mori atë që dëshironte, por edhe më shumë se ajo.”

(Marrë nga: [www.al-kawthar.com](http://www.al-kawthar.com))

**Profesor Pierre Lory, Universiteti i Sorbonës në Paris:** “Mesazhi i Zotit është i pakutimitë për mendjet e njerëzve, përvëç atyre që e marrin Husjenin shembull, përpinqen dhe sakrifikojnë në rrugën e Zotit për hir të besimit dhe demaskojnë mosbesimin në kohën e duhur.”

(Marrë nga: [www.alshirazi.net](http://www.alshirazi.net))

**Profesor Kostantin Matveev, studiues rus:** “Imam Husejni u martinizua si një luftëtar i guximshëm. Mënyra barbare si ai u vra, pati ndikime të mëdha politike dhe fetare tek të gjithë muslimanët. Ai u vra në këtë mënyrë të përgjakshme sepse donte të forconte shtyllat e të vërtetës dhe të rikthente jetëshkrimin e gjyshit të tij, profetit

..... Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë Muhammed (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!*)."  
(Marrë nga: [www.alshirazi.net](http://www.alshirazi.net))

**Dalai Lama, kreu i besimit budist:**  
"Nëse ne, budistët, do të kishim personalitetë të tillë si Imam Aliu dhe Husejni (*paqja qoftë mbi ta!*), nëse do të kishim *Nehxhu'l Belaga-n* dhe Kerbelanë, të gjithë njerëzit e botës do e përqafonin doktrinën budiste. Ne jemi krenarë për këto dy personalitetë islame."

(Marrë nga: [www.alshirazi.net](http://www.alshirazi.net))

**Dr. Daniel Isak Odishu, arkeolog asiriran nga Iraku:** "Vërtet, fletët e trupit të Husejnит (*paqja qoftë mbi të!*) u shndërruan në një libër prej gjaku. Ato fletë shkruajtën qëndrimet më të shenjta të heroizmit dhe fisnikërisë. Unë i lexova ato gërma të plagëve dhe ishin 67 gërma, ku 33 prej tyre ishin

*Vullnet Merja .....*

goditje shtizash dhe 34 ishin goditje shpatash."

(Marrë nga: [www.alshirazi.net](http://www.alshirazi.net))

**Dr. Ram Roshan Ji Laji Kumar, shkrimtar indian i letërsisë hindu:** "Unë nuk jam musliman, por jam i bindur se jam një musliman për Husejnин (*paqja qoftë mbi të!*). Jam musliman për hir të Imamit që na mësoi rrugën e humanizmit dhe na tregoi rrugën që të çon tek liria."

(Marrë nga: [www.alshirazi.net](http://www.alshirazi.net))

**Marona Benjamin Arsanis, studiues dhe artist asirian rus:** "Nuk ka dyshim se Husejni (*paqja qoftë mbi të!*) është shembull në rrugën konsolidimit të parimeve të drejta. Ai u ngrit për të shpëtuar të privuarit e të shtypurit nga duart e tiranëve dhe të padrejtëve."

(Marrë nga: [www.alshirazi.net](http://www.alshirazi.net))

..... *Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë*

**Profesor Ian Keith Anderson**

**Howard, hulumtues britanik:** "Ai që mendon se tragjedia e Kerbelasë ishte e padobishme, e palavdishme dhe se dobëson lidhjen e historisë islame, ai shpreh keqkuptimin e tij nxitures për besimin islam dhe për personalitetin e Imam Husejnит (*paqja qoftë mbi të!*)."

(Marrë nga: [www.alshirazi.net](http://www.alshirazi.net))

**Profesor Jan Arvid Henningsson, kancelar në Kishën Suedezë:** "Me revolucionin dhe martirizimin e tij, Husejni posedonte një aftësi shumë të madhe me qëllim të dialogut mes Krishtërimit dhe Islamit. Vërtet, Husejni (*paqja qoftë mbi të!*) mund të bëhet urë lidhëse mes të krishterëve dhe myslimanëve."

(Marrë nga: [www.alshirazi.net](http://www.alshirazi.net))

*Vullnet Merja .....*

**Dr. Sabrina Leon Mervin, studiuese franceze:** “Vërtet, Husejni, djali i Aliut (*paqja qoftë mbi ta!*) ka luajtur një rol shumë të madh në historinë e Islamit shi’it. Me martirizmin e tij i dha një kuptim të plotë lëvizjes fetare. Ai u bë simbol i shenjtë, veçanërisht tek shi’itet. Kjo duket qartë tek ritet husejniane, tek tubimet dhe karvanet përkujtimore dhe tek zigaretet.”

(Marrë nga: [www.alshirazi.net](http://www.alshirazi.net))

**Dr. Narat Gotom Suami, kreu i budistëve në qytetin Mahrishter, Indi:** “Vërtet, Imam Aliu ofroi djalin e tij, Imam Husjenin (*paqja qoftë mbi të!*) kurban për humanizmin duke sakrifikur veten e tij për të tjerët. Nuk është e mundur të gjejmë një të ngjashëm si ai në histori. Mund të thuhet se ai i përket një strukture unike.”

(Marrë nga: [www.alshirazi.net](http://www.alshirazi.net))

..... Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë

**Mendimtari rus Tolstoi:** “Ajo që s’ka dyshim éshtë se Husejni ka qenë prej burrave madhështorë, të cilët u ngritën për të kundërshtuar udhëheqësit që devijuan nga rruga e drejtë. Me atë qëndrim të tij, ai fitoi atë martirizim që e dëshiron çdo i lirë.”

(Marrë nga: [www.alshirazi.net](http://www.alshirazi.net))

**Shkrimtari francez Viktor Hygo:** “Parimet e revolucionit të Husejninit u bënë metodologji për çdo kryengritës që dëshiron të marrë të drejtën e tij nga i padrejti.”

(Marrë nga: [www.alshirazi.net](http://www.alshirazi.net))

**Kur muslimanët u ngritën në Çeçeni, Stalini ka thënë:** “Vriteni Kerbelanë, sepse, përderisa Kerbelaja éshtë e pranishme edhe problemet tona do të vazhdojnë. Ajo lind dhe përhap shumë burra në horizonte.”

(Marrë nga: [www.alshirazi.net](http://www.alshirazi.net))

*Vullnet Merja .....*

**Adolf Hitler:** “O ju ushtarë të guximshëm! Ndiqeni shembullin e asaj elite këmbëngulëse që u bashkua me udhëheqësin e saj, Husejn, i cili arriti të lëkundte bazat e shtetit të fuqishëm. Pasi iu dobësuan themelet, për shkak të veprës heroike të atij grupei durimtarësh, ai shtet ra në greminë.”

(Marrë nga: *www.alshirazi.net*)

**Ahmed Sukarno, udhëheqës i Indonezisë:** “Husejni është flamur valëvitës të cilin e mbart ai që dëshiron të sfidojë tiranët e kohës së tij, të cilët kënaqen me kënaqësitë e kësaj jete duke i lënë popujt e tyre në shtypje e mjerim.”

(Marrë nga *http://burathanews.com*)

**Revolucionari kubanez Çe Guevara:** “Të gjithë revolucionarët në botë duhet të ndjekin revolucionin e fuqishëm, të cilin e udhëhoqi komandanti i patundur, Husejni i

..... Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë madh. Duhet të ecin në vijën e atij revolucioni për të mposhtur udhëheqësit keqbërës dhe për të përmbysur kokat e tyre të mykura.”

(Marrë nga <http://burathanews.com>)

**Ho Shi Minh, udhëheqësi i Vietnamit:** “O ushtarë trima, kur të jeni në llogore, mendojeni atë burrë lindor, Husejnin e madh, i cili lëkundi tokën nën këmbët e tiranëve.”

(Marrë nga <http://burathanews.com>)

**Salvador Alende, president i Kilit:** “Popujt e kësaj bote kanë sjellë burra të mëdhenj, të cilët u bënë simbol për ta. Prej atyre simboleve është Husejni, Gandhi, Ho Shi Minh e të tjerë, të cilët kanë hyrë në regjistrin e të përjetshëmve.”

(Marrë nga <http://burathanews.com>)

*Vullnet Merja .....*

**Ugira, mendimtar rus:** "Husejni është bërë simbol që e ndjekin të gjithë popujt e shtypur, të cilët vuajtën arbitraritetin e padrejtësisë së udhëheqësve që i ndërtuan pushtetet e tyre të lëkundura mbi kafkat e të privuarve..."

(Marrë nga <http://burathanews.com>)

**Gjenerali De Gol, president i Francës:** "Qëndrimi i Husejninit më kujtoi qëndrimin guximtar përballë personit që dëshironte vrasjen e tij dhe të familjes së tij, e cila ka pozitë të lartë në shumë popuj të botës. Atë patjetër duhet ta lavdërojmë dhe të marrim prej parimeve të tij të larta."

(Marrë nga <http://burathanews.com>)

**Mao Ce Dun, udhëheqës i Kinës,** kur revolucionarja algjeriane Xhemile Bu Hajdar e pyeti për revolucionin kinez, ai tha: "Ju

..... Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë keni mësime dhe keni ardhur të merrni mësime?! I keni te revolucioni i Husejnit.”  
(Marrë nga <http://burathanews.com>)

**Martin Luther, reformator gjerman:**  
“Unë e ftoj popullin tim në reformë fetare dhe të jenë në pajtueshmëri me njëri-tjetrin. Të marrin shembull për këtë reformim fetar atë reformim në të cilin ftoi udhëheqësi arab Husejn ibn Ali.”  
(Marrë nga <http://burathanews.com>)

**Komandanti Abdul Kerim Kasim:** “U kërkoj juve që të bëni lutje për ne tek udhëheqësi i të lirëve, komandanti i revolucionarëve dhe simboli i përjetshëm, padroni im Husejni.”  
(Marrë nga <http://burathanews.com>)

**Muhamedi V, mbreti i Marokut:** “Ne, arabët dhe muslimanët, jemi krenarë për ata

*Vullnet Merja .....*

simbole të mëdhenj si Husejni e të tjerë, të cilët mbartën parimet më të përsosura, më të larta e më të vyera, të cilat u kushtuan atyre me jetë.”

(Marrë nga <http://burathanews.com>)

**Esh-Shadhlij bin Xhedid, president i Algjerisë:** “Husejni ishte prej prijësve të mëdhenj të lëvizjes revolucionare globale, sepse ai është prej themeluesve të kësaj lëvizjeje, e cila tmerroi poseduesit e pushteteve të dobëta. Ajo lëvizje i hodhi ata në greminë, e cila është vendi që e meritojnë.”

(Marrë nga <http://burathanews.com>)

**Mbreti Fejsal II,** kur vizitoi Kerbelanë ka thënë: “Kjo është dita më e lumtur në jetën time, se unë ndodhem pranë gjyshit tim Husejnит, me të cilin krenohem për të shkuarën e tij të ndritur, për mendimet e tij

..... Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë largpamëse dhe për qëndrimin e tij guximtar.”

(Marrë nga <http://burathanews.com>)

**Ko Jana, shkrimtar japonez:**  
“Revolucioni i Husejnit është dritë për të privuarit në rrugën e shpëtimit të tyre. Ai u forcoi atyre këmbët dhe i nxorri ata nga errësirat. Ai u ndriçoi atyre ndërgjegjet për të ndjekur të vërtetën.”

(Marrë nga <http://burathanews.com>)

**Mendimtari Majkëll Anglua:**  
“Husejni nuk donte të merrte pushtetin që të udhëhiqte, por ai donte që t'u jepte mësim udhëheqësve shtypës, të cilët mendonin se do të qëndronin përgjithmonë. Me revolucionin e tij, ai u mësoi atyre se patjetër do të bien në dorën e popullit të tyre.”

(Marrë nga <http://burathanews.com>)

*Vullnet Merja .....*

**Shkrimtari      Xhorxh      Lukas:**

“Konceptet e Husejnit ishin tē përqendruara tek natyrshmëria e lirë. Qëllimet e tyre ishin që bijtë e ummetit tē tij tē jenë tē lumtur nē jetën e tyre, me qëllim që tē kenë mundësinë tē qëndrojnë përballë udhëheqësve tē padrejtë, tē cilët shtypin qafat e tyre. Husejni u përball me ta me gjithë fuqinë dhe vendosmërinë.”

(Marrë nga <http://burathanews.com>)

**Mustafa Kemal Ataturk ka thënë:**

“Vërtet, Husejni është udhëheqës i rrallë e i pashoq. Ai është mësues i mësimeve tē vyera në luftën për liri dhe për mbrojtjen e nderit.”

(Marrë nga <http://burathanews.com>)

**Abraham Lincoln, president i Amerikës:** “Vërtet, Kur’ani, Muhamedi dhe Husejni janë ‘trini e shenjtë’ dhe duhen parë me syrin e shenjtërisë, sepse në to ka shumë

..... Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë shembuj të lartë dhe shemuj respekti për të drejtat e njeriut.”

(Marrë nga <http://burathanews.com>)

**Shkrimtari Ernest Hemingeuj ka thënë:** “Vërtet, hidhërimi që shkaktoi vrasja e Husejnit vazhdon të djegë e të përvëlojë zemrat e njerëzve të ndritur për shkak të tragjedisë së dhimbshme, të cilën e kryen grupi i të eturve për gjakun e të pafajshmëve.”

(Marrë nga <http://burathanews.com>)

**Zhorzh Pompidou, president i Francës:** “Të mëdhenjtë kanë virtute dhe cilësi të shumta. Popujt kanë sjellë shumë prej atyre që historia i përmend me germa prej drite. Në krye të tyre kanë qenë Krishti, Muhamed, Buda dhe Husejni.”

(Marrë nga <http://burathanews.com>)

*Vullnet Merja .....*

**Mendimtari anglez, Bernard Shou:**

“Çdo njeri i ndritur qëndron me respekt dhe nderim para atij udhëheqësi madhështor, nipi të Profetit të Islamit, i cili qëndroi i palëkundur para një grupei shkurtabiqësh, të cilët tmerruan dhe persekutuan popujt e tyre.”

(Marrë nga: <http://burathanews.com>)

**Kurt Valdhajm:** “E kam lexuar me pasion udhën e historisë në të cilën eci Husejni, i biri i Aliut dhe e kam gjetur të mbushur me altruizëm dhe sakrifica përmbrojtjen e parimeve dhe të idealeve të larta, përrrealizimin e të cilave sakrifikoi veten.”

(Marrë nga: <http://burathanews.com>)

**Raxhif Gandhi, president i Indisë:**

“Është detyrë që Husejni dhe të tjera që ecën në rrugën e tij prej të mëdhenjve të botës të shihen me shikimin e respektit dhe të

..... *Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë shenjtërisë për arsyet e parimeve të larta dhe mendimeve të mrekullueshme që ata mbartnin.”*

(Marrë nga: <http://burathanews.com>)

**Napoleoni, udhëheqësi francez,** vëllait të tij, i cili e shoqëronte dhe dëshironte të kthehej në vendin e tij, i ka thënë i zemëruar: “Të pandeha se je si vëllai i Husejn!”

(Marrë nga: <http://burathanews.com>)

**Shilley, shkrimtar anglez:** “Husejni nuk është pronë e askujt. Përkundrazi, ai është pronë e të gjithëve, sepse mendimet e tij janë të drejta. Prej atyre përfiton kushdo që dëshiron të jetë simbol i popullit dhe i bashkësisë së tij.”

(Marrë nga: <http://burathanews.com>)

**Perez de Kuelar, ish sekretar i përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të**

*Vullnet Merja .....*

**Bashkuara:** "I kam parë (lexuar) librat e konsiderueshëm të historisë që flasin për udhëheqësit të cilët dhanë gjakun e tyre për të lumturuar popujt e vet. Vura re se nipi i Profetit të muslimanëve, i biri i Aliut, ka qenë më i forti dhe më i guximtari i tyre."

(Marrë nga: <http://burathanews.com>)

**Lubid Singor, president i Senegalit:**  
"Husejni, i biri i Aliut, ka qenë shembulli më i lartë në sakrificat për zhdukjen e pavërtetësisë dhe në luftimin e diktatorëve."

(Marrë nga: <http://burathanews.com>)

**Ruzvelti, ish-president i Amerikës:**  
"Sado që të arrijnë luftëtarët në gjendjen e egërsisë, të luftimit dhe të agresionit, ne kurrë nuk e pranojmë vrasjen e djalit të një vajze, që i atribuohet një Profeti."

(Marrë nga: <http://burathanews.com>)

..... *Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë*

## Përbajtja

Fjala e Shoqatës.....	7
Husejni ( <i>paqja qoftë mbi të!</i> ), drita e pestë.....	13
Ndodhitë në ditën e Ashuras sipas burimeve të Ehli Sunnetit.....	21
Ashuraja në pikëpamjet e disa filozofëve, mendimtarëve,        udhëheqësve        dhe politikanëve të botës.....	33

..... *Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë*

*Vullnet Merja .....*

**اسم الكراسة:** عبق ريحانة من ارض كربلاء

**الاعداد:** الحاج الشيخ ولنت مريما

**التصحيح اللغوى:** الحاج يتمير چلا

**مقابله:** سونيلا كاظمى

**الاخراج و ديزاينر:** صبريه برا

**الناشر:** جمعية النسيم

..... Aromë borziloku nga toka e Kerbelasë

# عقب ريحانة من ارض كربلاء

الاعداد:ال الحاج الشيخ ولنت مريما

تيرانا 2013 محرم الحرام 1435